



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA LEZHË  
KËSHILLI I BASHKISË LEZHË

Nr. 361 Prot

Lezhë, më 06 / 05 /2022

VENDIM

Nr. 46, Datë 04 . 05 .2022

**Për përdorimin e Fondit të Kontigjencës, për mbulimin e shpenzimeve të paparashikuara në buxhetin e vitit 2022**

Në zbatim të nenin 54, të ligjit Nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjes Vendore”; të ligjit Nr.68, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”; të ligjit Nr.9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; dhe të Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë Nr.9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli i Bashkisë Lezhë;

**Vendosi :**

- Miratimin e përdorimit të Fondit të Kontigjencës në shumën 854,108 lekë, për mbulimin e shpenzimeve të paparashikuara në buxhetin e vitit 2022, për këtë të kryhen veprimet si më poshtë:
  - Pakësohet: Gr.00, Prog.01110, Kap.01, Art.609 për shumën 854,108 lekë.
  - Shtohet: Gr.00, Prog.09230, Kap.01, Art.231 për shumën 854,108 lekë, fond i cili do të përdoret për mbulimin e shpenzimeve për objektin: “Rikonstruksion i Qendrës Rinore Lezhë”, respektivisht për: Rikonstruksionin e objektit 770,446.4 lekë, supervizim punimesh 74,698.8 lekë dhe kolaudim punimesh 8,962.8 lekë.
- Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
- Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

SEKRETARI

FLORIDA ÇUNAJ

KRYETARI

ERNEST RAKAJ

